




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN



VENDIM

Nr.3, datë 24.03.2022

PËR

KORRIGJIMIN E KOORDINATAVE DHE MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR PËRDORIM TËBURMIT UJOR NËNTOKËSOR ME NR. 657/1 PORT., DATË 14.07.2017 MIRATUAR ME VENDIM NR.5 DATË 29.06.2017 NGA KBU SEMAN”, DHËNË NË FAVOR TË SHOQËRISË “BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD”

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e koordinatave të lejes nr.prot.657/1, datë 14.07.2017 miratuar me vendimin nr.5, datë 29.06.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Seman si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit (KRGJSH)

Nga: X=471270.1; Y= 4508672.1; Z= 18.6 m.m.n.d.

Në : X=471334; Y= 4510606.7; Z= 13 m.m.n.d.

Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=4.6l/s

2. Miratimin e rinovimit të lejes nr.657/1,prot., datë 14.07.2017 miratuar me vendimin nr.5, datë 29.06.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Seman për “Përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime teknologjike” sipas këtyre të dhënave:

Vendndodhja e pus shpimit (KRGJSH)

Në : X=471334; Y= 4510606.7; Z= 13 m.m.n.d.

Sasia e ujqit që jepet në përdorim: $Q=0.0046 \text{ m}^3/\text{s}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

